VENDIM
Nr. 143, datë 24.9.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË "DEVOLL HYDROPOWER" SHA, ME NR. 274, SERIA T15, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 35, DATË 4.3.2015

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa "e"; nenit 5, pika 1, germa "e"; nenit 10, pikat 1 dhe 3 dhe nenit 16 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa "a" të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e datës 24.9.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 89/10 prot., datë 13.9.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes mbi kërkesën e shoqërisë "Devoll Hydropower" sh.a., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria "Devoll Hydropower" sh.a. është mbajtëse e licencës me nr. 274, seria T15 të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendim të bordit të ERE-s nr. 35, datë 4.3.2015, me afat 5-vjeçar. Afati i kësaj licence përfundon në datën 4.3.2020.

- Shoqëria "Devoll Hydropower" sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 529, datë 2.9.2019, ka aplikuar për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Aplikanti ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës, në zbatim të afateve të parashikuara në nenin 16 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", jo me vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.

- Aplikimi i shoqërisë "Devoll Hydropower" sh.a., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikimit (neni 9, pika 1, germat "a", "b", "c") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "d", "e") është plotësuar pjesërisht.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat "a", "b", "c", "d") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germat "a", "b", "c", "d") është plotësuar pjesërisht.

Për dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:

"Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor", neni 9, pika, germa "b" (mungon akti i themelimit).

"Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike", neni 9, pika 4.8, germat "a" (mungon sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t'u tregtuar në GWh sipas viteve).

Neni 9, pika 4.8, germat "b" (mungon kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie). Neni 9, pika 4.8, germat "c" (mungon lista e kontratave të mëparshme, të realizuara, nëse ka pasur);

do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 10, pika 9 dhe nenit 11, pika 1 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", t'i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë "Devoll Hydropower" sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë nr. 274, seria T15, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 35, datë 4.3.2015, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

ANËTAR I AUTORIZUAR
Adriatik Bego